MEPSO

GAZETA ELEKTRONIKE

Numër 5

Shkurt, 2026

Intervistë me

Semijal Ziberi

Udhëheqese e departamentit për zhillim dhe investime

Gratë në energjetikë

Stanisllava Sokollovska

Elektroinxhiniere

OOPERATOR I SISTEMIT ELEKTROTRANSMETUES

Email: info@mepso.com.mk Tel: +389 2 314 9811

MEPSO

PËRMBAJTJA

AKTUALITETE - 4

INTERVISTË - 7

PROJEKTE - 12

STACIONI I TRANSFORMUESIT - 18

GRATË NË ENERGJETIKË - 21

NJË DITË ME SISTEMET E MBIKQYRJES DHE MENAXHIMIT - 25

KONFERENCA/DEBATE - 28

ORGANIZATA SINDIKALE E SHA MEPSO - 31

PUNONJËSIT DHE MEPSO - 32

LAJME NGA BOTA - 34

Botuar nga Sha MEPSO

Rr, Maksin Gorki nr. 4, Shkup

Republika e Maqedonise se Veriut

www.mepso.com.mk

Drejtori Gjeneral:

Prof. D-r Burim Latifi

Pergatitja teknike;

Irina Daskallovska Qosevska

Violeta Z.Stojanovska

Emine Abazi Gashi

Selvije Ramani

FILLUAN RREGULLAT E REJA PËR PROKURIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË MBULUAR HUMBJET NË RRJETIN E TRANSMETIMIT

Që nga 1 shkurti 2026, kanë hyrë në fuqi Rregullat e reja për prokurimin e energjisë elektrike për të mbuluar humbjet në rrjetin e transmetimit, të miratuara në përputhje me Ligjin për Energjetikë dhe të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 9/2026. Prokurimi i parë sipas procedurave të reja për periudhën shkurt-mars 2026 u realizua me sukses të plotë, duke sjellë përfitime të qarta ekonomike dhe duke konfirmuar efektivitetin e ndryshimeve të bëra.

Rregullat e reja sjellin fleksibilitet dhe precisitet më të madh në planifikimin e nevojave për energji për mbulimin e humbjeve. Ndër risitë kryesore janë:Mundësia e blerjes së energjisë në periudha të shumta kohore gjatë ditës – kjo lejon planifikim më të mirë, parashikime më të sakta të humbjeve dhe ulje të kostove totale, ndërsa ofertuesve u jep liri më të madhe për të ofruar energji sipas disponueshmërisë së tyre.

NËNSHKRUHET KONTRATA PËR NDËRTIMIN E LINJËS SË TRANSMETIMIT 400 kV MANASTIR-ELBASAN

Rifillon zyrtarisht projekti strategjik për ndërtimin e linjave të transmetimit 400 kV nga TS Manastir deri në kufirin Maqedoni-Shqipëri. Me nënshkrimin e kontratës për ndërtimin e këtij interkoneksioni, me kontraktorin e ri – konsorciumi i udhëhequr nga Dalekovod nga Zagrebi – realizimi i projektit, i cili është me interes të lartë shtetëror, vazhdon zyrtarisht.

Kjo zgjedhje vjen pas vendimit strategjikisht të domosdoshëm të menaxhmentit për ndërprerjen e kontratës së mëparshme, e cila e kishte kompromet uar dhe vonuar projektin për një kohë të gjatë. Realizimi i këtij projekti mbyll të vetmin segment të hapur në sistemin tonë të transmetimit, duke mundësuar plotësimin e plotë të Korridorit energjetik rajonal 8 dhe përmirësim të konsiderueshëm të kushteve të tensionit në pjesën jugperëndimore të vendit.

PËRGATITJE INTENZIVE PËR INSTALIMIN E TRANSFORMATORIT TË SERVISUAR 400/110 KV

Në TS Dubrovë vazhdojnë përgatitjet intensive për mbërritjen dhe instalimin e transformatorit të servisuar/ri 400/110 kV, i cili do të sigurojë funksionim të qëndrueshëm të kësaj stacioni transformator. Aktivitetet në terren po përparojnë me sukses, bashkërendimi i ekipeve teknike është i shkëlqyer dhe dinamika e projektit është në përputhje me strategjinë për modernizimin e rrjetit të transmetimit.Paralelisht po punohet intensivisht edhe në Data Disaster Recovery Center të ri, që rrit ndjeshëm nivelin e sigurisë digjitale dhe qëndrueshmërisë së sistemit të transmetimit. Me investime të vazhdueshme dhe përkushtim teknik, ShA MEPSO po ndërton një sistem energjetik të përgatitur për sfidat e ardhshme teknologjike dhe energjetike.

CERTIFIKATË PER RIAKREDITIMIN E DYTË TE LABORATORIT PËR MATERIALE IZOLUESE TË SHA MEPSO

Laboratori për materiale izoluese të ShA MEPSO fitoi riakreditimin e dytë. Certifikata është e vlefshme deri më 05.10.2029.

Laboratori, i themeluar në vitin 2000 është i vetmi i këtij lloji në vend dhe shërben si qendër për analiza me cilësi të lartë dhe mbështetje teknike për sektorin energjetik. Laboratori është i akredituar sipas standardit MKC EN ISO/IEC 17025:2018 dhe është I vetmi i këtij lloji në vend. Me shumë vite përkushtim dhe profesionalizm, laboratori ofron rezultate të besueshme dhe të sakta për të gjitha testet. Riakreditimi i ri konfirmon besimin në ekspertizën teknologjinë moderne dhe përgjegjësinë e lartë profesionale të ekipit që punon atje

AKTUALITETE

SHA MEPSO SHËNOI 20 VJETORIN E THEMELIMIT TË SAJ

SHA MEPSO Me një ngjarje solemne, ShA MEPSO shënoi 20-vjetorin e formimit të saj si institucion kyç në sistemin elektroenergjetik të Maqedonisë. Në jubile morën pjesë anëtarët e Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikëqyrës, ministra, deputetë, kryetarë bashkie, përfaqësues të korit diplomatik, sektori energjetik, partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, media si dhe shumë kolegë aktivë dhe të pensionuar

"Dy dekada nuk janë vetëm rrjedhë kohore. Është periudhë e pjekurisë institucionale, ndërtimit të kujtesës korporative dhe dëshmi e punës së përgjegjshme dhe profesionalizmit", theksoi drejtori gjeneral i ShA MEPSO, z. Burim Latifi.

"Misioni që nga dita e parë", tha ai, "është të sigurohet transmetim i sigurt sipas standardeve më të larta evropiane".

Ministrja për energjetikë, minera dhe lëndë të para, znj. Sanja Bozhinovska, foli për rolin e MEPSO-s si operator i qëndrueshëm dhe i besueshëm, si dhe faktor i rëndësishëm në procesin e integrimit evropian të sektorit energjetik.

Drejtuesit e njësive OST dhe ORrT, Sashko Lakinski dhe Vase Jovevski, u kthyen në historinë, zhvillimin dhe arritjet kryesore të kompanisë gjatë dy dekadave të fundit.

Shënimi i 20-vjetorit është një konfirmim i pjekurisë institucionale të kompanisë dhe përkushtimit për furnizim të sigurt, menaxhim të përgjegjshëm të burimeve publike dhe zhvillim të vazhdueshëm të sistemit nacional elektroenergjetik.

INTERVISTË ME SEMIJAL ZIBERI,UDHËHEQËSE E DEPARTAMENTIT PËR ZHVILLIM DHE INVESTIME

NGA STRATEGJIA NË TEREN : PROJEKTE INVESTUESE QË TRANSFORMOJNË SISTEMIN ELEKTROTRANSMETUES

Projektet investuese në rrjetin elektrotransmetues nuk janë vetëm ndërhyrje teknike, por vendime me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë e furnizimit, stabilitetin afatgjatë energjetik dhe pozicionimin e shtetit në tregun rajonal energjetik. Në kushtet e tranzicionit energjetik , lidhjes së shtuar rajonale dhe kërkesave të larta për sigurinë e sistemit, vendimet investuese marrin një rëndësi thelbësore.

Në ShA MEPSO, Departamenti për zhvillim dhe investime është vendi ku fillojnë të gjitha projektet kapitale në sistemin e transmetimit – nga planifikimi strategjik dhe konstruksioni financiar, deri në realizim dhe lidhje në rrjet.

BNë këtë intervistë me Semijal Ziberi, drejtuese e Departamentit për zhvillim dhe investime, diskutojmë për projektet më të rëndësishme aktuale, për sfidat në realizimin e investimeve kapitale dhe për vizionin për zhvillimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike maqedonas në kushtet e tranzicionit të shpejtuar energjetik.

Departamenti për investime dhe zhvillim shpesh përshkruhet si "arkitekti" i rrjetit të ardhshëm të transmetimit, pra si "pika hyrëse" e të gjitha projekteve në rrjet. Si e përcaktoni rolin e tij në sigurimin e zhvillimit afatgjatë, stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit elektroenergjetik?

► Departamenti për investime dhe zhvillim ka rolin e pikës qendrore ku bashkohen të gjitha aspektet e planifikimit dhe realizimit të rrjetit të ardhshëm të transmetimit. Brenda tij ekzistojnë disa shërbime që së bashku sigurojnë stabilitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemit elektroenergjetik. Shërbimi për planifikim strategjik dhe zhvillim përcakton vizionin dhe drejtimin e rrjetit, ndërsa analitika e performancës financiare dhe kontrolli sigurojnë përdorimin racional të mjeteve dhe disiplinën financiare. Ekipi GIS mundëson modelim dhe analizë precize të infrastrukturës, ndërsa standardizimi garanton pajtueshmërinë me rregulloret nacionale dhe evropiane.

Përveç këtyre funksioneve, rol të rëndësishëm ka edhe shërbimi për lidhje të konsumatorëve dhe prodhuesve, i cili kujdeset për procesin e lidhjes së përdoruesve të rinj dhe gjeneratorëve në rrjetin e transmetimit. Ai ofron kushte teknike, koordinim dhe integrim të kapaciteteve të reja, duke garantuar që rritja e konsumit dhe zhvillimi i burimeve të reja prodhuese të zhvillohet në

përputhje me planin e zhvillimit dhe pa cenuar stabilitetin e sistemit. Kësaj i shtohet edhe Shërbimi për menaxhim projektesh, i përbërë nga menaxherë projektesh dhe specialistë financiarë, të cilët mbajnë përgjegjësinë për zbatimin praktik – nga ideja fillestare deri te përfundimi i projektit, me kontroll të afateve, buxheteve dhe cilësisë. Në këtë mënyrë, departamenti nuk është vetëm një strukturë administrative, por "truri" i vërtetë që drejton energjinë e organizatës: nga vizioni dhe strategjia, përmes analizës financiare dhe teknike, deri te realizimi konkret i projekteve.
Me një strukturë të tillë, Departamenti siguron që çdo investim të jetë pjesë e një strategjie më të gjerë, që sistemi të jetë financiarisht i qëndrueshëm, teknikisht preciz dhe rezistent ndaj rreziqeve, dhe që projektet të zbatohen në kohë dhe me cilësi të lartë. Roli i departamentit mund të përcaktohet si garanci për zhvillimin afatgjatë dhe sigurinë e sistemit elektroenergjetik.

Si përcaktohen prioritetet investuese në kushte të ndalimit të tranzicionit dhe si ato harmonizohen me politikat nacionale energjetike ?

► Në kushtet e një tranzicioni të përshpejtuar energjetik, pikënisja për përcaktimin e prioriteteve investuese është Plani dhjetëvjeçar i zhvillimit të rrjetit të transmetimit, i cili përditësohet çdo dy vjet. Ky plan hartohet në bashkëpunim me Ministrinë e Energjetikës, ndërsa versioni i tij përfundimtar miratohet nga Komisioni Rregullator për Energjetikë (KRrE). Në këtë mënyrë sigurohet që çdo investim të jetë pjesë e një strategjie më të gjerë dhe të jetë në përputhje me politikat nacionale energjetike dhe objektivat afatgjata për zhvillimin e sistemit.
Në Ligjin e ri për Energjetikë i është kushtuar vëmendje e veçantë koordinimit të ndërsjellë të të gjitha institucioneve përkatëse, me qëllim harmonizimin më të mirë të investimeve dhe planifikimin sipas nevojave që imponohen nga integrimi i një numri gjithnjë e më të madh burimesh prodhuese. Kjo kornizë ligjore mundëson transparencë më të madhe dhe sinkronizim ndërmjet operatorit të sistemit të transmetimit, rregullatorit, ministrisë dhe pjesëmarrësve të tjerë në treg, në mënyrë që prioritetet të mos shihen vetëm si zgjidhje teknike, por si instrumente strategjike për garantimin e sigurisë, stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemit elektroenergjetik.
Në këtë mënyrë, prioritetet investuese përcaktohen mbi bazën e sigurisë së furnizimit, integrimit të burimeve të ripërtëritshme, ndërlidhjes rajonale dhe arsyeshmërisë ekonomike, por gjithmonë brenda një kornize të harmonizuar me politikat nacionale dhe kërkesat ligjore.

Interkoneksioni Manastir–Elbasan është një nga projektet më të rëndësishme strategjike të MEPSO-s. Nga perspektiva Juaj, çfarë e bën këtë projekt strategjik si për shtetin ashtu edhe për lidhjen elektroenergjetike rajonale?

► Interkoneksioni Manastir –Elbasan është një nga projektet më të rëndësishme strategjike të MEPSO-s në dekadat e fundit, sepse me realizimin e tij praktikisht mbyllet një boshllëk i madh në qarkullimin e energjisë elektrike në korridorin energjetik evropian 8. Deri tani ka ekzistuar një ndërprerje në vazhdimësinë e infrastrukturës së transmetimit përgjatë këtij korridori, çka kufizonte mundësinë për integrim të plotë rajonal dhe shkëmbim të energjisë elektrike mes vendeve.

Në Maqedoni tashmë janë ndërtuar të gjitha lidhjet ndërkombëtare energjetike me vendet fqinje, dhe vetëm lidhja me Shqipërinë mungonte. Me ndërtimin e linjës së transmetimit Manastir–Elbasan, ky boshllëk mbyllet dhe sigurohet një lidhje e drejtpërdrejtë mes sistemit të transmetimit të Maqedonisë dhe Shqipërisë. Kjo do të thotë siguri më e lartë e furnizimit, fleksibilitet i shtuar për integrimin e burimeve të

reja prodhuese dhe stabilitet më i madh i të gjithë sistemit rajonal.

Kur flasim për interkoneksione, duhet theksuar se në energjetikë nuk ekzistojnë sisteme të pavarura. Energjia elektrike nuk rrjedh në një qark të mbyllur brenda një shteti, por përkundrazi, për shkak të stabilitetit të rrjetit, lidhjet ndërkombëtare janë të domosdoshme. Ato mundësojnë balancimin e sistemeve, sigurinë e furnizimit dhe integrimin e burimeve të reja të energjisë, duke e bërë projektin Manastir–Elbasan jo vetëm me rëndësi nacionale, por edhe strategjikisht rajonal.

Me realizimin e tij, Maqedonia bëhet plotësisht e lidhur me të gjithë fqinjët e saj, dhe korridori 8 fiton një dimension të ri funksionaliteti dhe rëndësie, duke e forcuar pozicionin e shtetit në rrjedhat energjetike evropiane.

Cilat ishin sfidat kryesore gjatë përgatitjes për rinisjen e këtij projekti kompleks?

►Sfidat kryesore gjatë përgatitjes për rinisjen e projektit ndërkombëtar Manastir–Elbasan ishin vërtet të shumta dhe komplekse, pasi duhej të ndërthureshin aspektet teknike, pronësore-juridike dhe ndërkombëtare. Së pari, vetë vendimi i guximshëm për ndërprerjen e kontratës së mëparshme erdhi pas një analize të thellë dhe ekspertizës së historikut të projektit, ku u vërejt një zvarritje shumëvjeçare dhe negociata të gjata rreth detajeve teknike dhe ndryshimeve të çmimeve. Ishte koha e fundit për një vendim të tillë, i cili hapi detyrime që duhej të plotësoheshin pas ndërprerjes, si marrja e pajisjeve të blera më parë dhe përballja me faktin se vetëm një përqindje e vogël e punimeve ishte realizuar. Kjo krijoi peshë shtesë në proces, sepse duhej siguruar vazhdimësia dhe të mos humbnin fondet dhe resurset e investuara tashmë.

Më tej, përgatitja e dokumentacionit për rishpallje tenderi paraqiti një detyrë jashtëzakonisht komplekse, sidomos duke pasur parasysh se projekti financohet nga BERZH dhe duhet të realizohet sipas rregullave FIDIC. Kompleksitet shtesë erdhi nga ndryshimi i modelit kontraktual – kontrata e mëparshme ishte sipas "Yellow Book", ndërsa e reja realizohet sipas "Red Book". Kjo kërkonte përshtatjen e të gjithë dokumentacionit, proceseve dhe detyrimeve me formatin e ri ligjor dhe teknik, që nënkuptonte rishqyrtimin dhe riharmonizimin e të gjitha aspekteve me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e kreditorit.

Në përmbledhje, rinisja e projektit kërkoi menaxhim të njëkohshëm të çështjeve pronësore-juridike, sfidave teknike dhe organizative, si dhe koordinim ndërkombëtar me kreditorët dhe përputhje me rregullat FIDIC. E gjithë kjo e bën përgatitjen një nga detyrat më të ndërlikuara, por edhe më të rëndësishmet për të siguruar realizimin e suksesshëm të këtij projekti strategjik.

Çfarë ndikimi kanë ndërlidhjet në pozicionin e Maqedonisë në tregun rajonal të energjisë elektrike dhe në stabilitetin e sistemit?

► Këto interkoneksione e forcojnë drejtpërdrejt pozitën e Maqedonisë në tregun rajonal të energjisë elektrike, sepse e bëjnë vendin plotësisht të integruar në rrjetin rajonal të transmetimit dhe pjesë të rrjedhave energjetike evropiane. Me vendosjen e të gjitha lidhjeve ndërkufitare, Maqedonia fiton mundësi për tregti më të gjerë me energji elektrike, shfrytëzim më efikas të kapaciteteve vendore dhe qasje në burime shtesë në periudha të rritjes së kërkesës.
Interkoneksionet gjithashtu rrisin aftësinë e sistemit për të përballuar goditje dhe paqëndrueshmëri të mundshme. Kur ekziston një infrastrukturë e fuqishme interkonektive, sistemi mund të reagojë ndaj situatave të paparashikuara, si ndërprerje në prodhim, ndryshime të papritura në konsum apo kriza rajonale, përmes importit ose eksportit të energjisë dhe balancimit të rrjetit.

Me fjalë të tjera, interkoneksionet e shndërrojnë Maqedoninë në një pjesëmarrës aktiv në tregun rajonal, ndërsa njëkohësisht e bëjnë rrjetin e transmetimit më të qëndrueshëm, më fleksibil dhe më të aftë për t'u përballur me dinamikën e tranzicionit energjetik.

Cilat investime të tjera kapitale përcaktojnë ciklin e zhvillimit të ShA MEPSO dhe si lidhen ato me një vizion më të gjerë për rrjetin e transmetimit?

►Investimet kapitale të ShA MEPSO janë të orientuara drejt modernizimit dhe forcimit të plotë të rrjetit të transmetimit, me një vizion të qartë për krijimin e një sistemi elektroenergjetik të qëndrueshëm, fleksibël dhe të integruar rajonalisht. Është në fazën përfundimtare projekti "Rehabilitation and Control", i mbështetur nga BERZH, përmes të cilit janë rehabilituar disa linja kritike të transmetimit, ndër të cilat edhe Prilep–Manastir 1, e cila tashmë është vënë në funksion.

Në periudhën e ardhshme fillon realizimi i njërit prej projekteve më të rëndësishme të brendshme – rikonstruksioni dhe ndërtimi i korridorit të linjave Gostivar–Kërçovë–Osllomej–Sopotnicë–Manastir 1 me mjete vetanake, si dhe projekti për forcimin e rrjetit në pjesën juglindore të vendit dhe themelimin e një qendre trajnimi në Ohër, gjithashtu i mbështetur nga BERZH.

Paralelisht po përgatiten projektet për digjitalizim, sisteme moderne të monitorimit dhe forcim të sigurisë kibernetike, të cilat do të realizohen gjatë këtij viti, ndërsa nga viti i ardhshëm fokusi zhvendoset në rikonstruksionin e linjave të mbetura të amortizuara dhe në zhvillimin strategjik të rrjetit 400 kV, duke përfshirë linjën e re 400 kV Shkup–Tetovë–Kosovë dhe një interkoneksion të ri me Kosovën.

Tranzicioni energjetik po e ridimensionon qasjen investuese të MEPSO-s, nga ndërhyrje klasike infrastrukturore drejt ndërtimit të një rrjeti transmetimi fleksibël, inteligjent dhe të ndërlidhur rajonalisht. Integrimi i një numri gjithnjë e më të madh burimesh të ripërtëritshme ka rol kyç në prioritarizimin e investimeve, pasi kërkon korridore të reja transmetimi, kapacitete më të mëdha të rrjetit dhe zgjidhje të avancuara digjitale për menaxhimin e prodhimit variabil. Nevoja për sisteme moderne dhe të automatizuara, si dhe për interkonektivitet të zgjeruar, po e formëson vizionin e ri të zhvillimit – një rrjet që do të jetë në gjendje të mbështesë në mënyrë të sigurt rritjen e përshpejtuar të burimeve të energjisë së ripërtëritshme dhe stabilitetin e sistemit elektroenergjetik në dekadat që vijnë.

Sa e rëndësishme është mbështetja institucionale dhe ndërkombëtare në zbatimin e projekteve kapitale të kësaj shkalle dhe rëndësie, dhe ku shfaqen më shpesh "pengesat"?

►Mbështetja dhe koordinimi me Qeverinë, veçanërisht me Ministrinë e Energjetikës si themeluesi ynë, si dhe me Komisionin Rregullator për Energjetikë dhe partnerët ndërkombëtarë, janë thelbësore për realizimin e projekteve kapitale të këtij dimensioni dhe rëndësie. Ato sigurojnë harmonizimin e politikave, stabilitet rregullator, siguri financiare, si dhe dhënien me kohë të lejeve dhe pëlqimeve të nevojshme. Nga ana tjetër, partnerët ndërkombëtarë, përveç mbështetjes financiare, kontribuojnë me standarde, praktika të mira dhe mekanizma për kontrollin e cilësisë dhe transparencës.

"Të ashtuquajturat" ngushtica apo pengesa më të shpeshta paraqiten në procedurat komplekse administrative, në dinamikën e lëshimit të lejeve, në harmonizimin e detyrimeve rregullatore me nevojat teknike të projekteve, si dhe në koordinimin ndërmjet shumë institucioneve. Ashtu si në të gjitha investimet e tjera publike, çështjet e pazgjidhura pronësore-juridike paraqesin një problem kronik, ndërsa në rastin

tonë shpeshherë janë faktori kyç që përcakton nëse një projekt do të avancojë apo do të përballet me vonesa serioze.

Për më tepër, te partnerët ndërkombëtarë sfida shtesë krijojnë procedurat e ndërlikuara, afatet për rishikim dhe nevoja për përputhje të plotë me standardet e tyre, gjë që kërkon përgatitje të lartë, saktësi dhe disiplinë. Prandaj, koordinimi i fortë dhe i vazhdueshëm me të gjithë këta aktorë është thelbësor për të shmangur pengesat dhe për të siguruar një realizim në kohë, të parashikueshëm dhe të suksesshëm të investimeve strategjike.

Cilat mekanizma i konsideroni kyç për të siguruar transparencën dhe disiplinën financiare në zbatimin e projekteve kapitale të kësaj shkalle?

►Transparenca dhe disiplina financiare janë thelbësore për projekte kapitale të këtij dimensioni, ndërsa besimi ndërtohet përmes disa mekanizmave bazë: raportimit të rregullt dhe publik mbi ecurinë e projekteve, duke përfshirë dinamikën, rrjedhat financiare dhe rezultatet e arritura; kontrolleve të forta të brendshme dhe auditimeve të pavarura që konfirmojnë se mjetet përdoren në mënyrë strikte në përputhje me procedurat; procedurave plotësisht transparente dhe konkurruese të prokurimit publik që eliminojnë çdo dyshim për favorizime; si dhe komunikimit aktiv e të hapur dhe harmonizimit me procedurat dhe standardet e institucioneve financiare ndërkombëtare dhe partnerëve.

Përmes këtyre mekanizmave sigurohen parashikueshmëria, integriteti dhe besimi – si në opinionin publik, ashtu edhe tek të gjitha palët e interesuara.

Cilat do të jenë sfidat energjetike për rrjetin e transmetimit në 10-15 vitet e ardhshme?

►Në 10–15 vitet e ardhshme, rrjeti i transmetimit do të përballet me tre sfida kryesore: menaxhimin e mençur të diversitetit dhe rritjes së burimeve të ripërtëritshme, integrimin e tyre të përshpejtuar, nevojën për forcimin e interkoneksioneve rajonale dhe modernizimin masiv të infrastrukturës së vjetëruar.

Sektori energjetik sot zhvillohet me një ritëm të jashtëzakonshëm. Zhvillimi i burimeve të ripërtëritshme, digjitalizimi dhe ndryshimet në treg po ndodhin shumë më shpejt se më parë, gjë që kërkon fokus të vazhdueshëm, shkallë të lartë agiliteti dhe përkushtim të fortë institucional. Mosarritja për ta ndjekur këtë zhvillim dinamik nuk duhet të lejohet, pasi do të nënkuptonte integrim të kufizuar të kapaciteteve të reja prodhuese dhe rritje të rreziqeve për sigurinë dhe stabilitetin e sistemit.

A Për të ecur përpara me siguri, nevojiten investime në kohë në korridore të reja transmetimi, zgjidhje digjitale fleksibile dhe të sigurta, si dhe interkonektivitet i forcuar; zgjerim dhe modernizim i kapaciteteve transformatorike; përmirësim i rregullimit të tensionit tdhe mbështetjes reakti ve; si dhe zhvillim i shërbimeve sistemore dhe zgjidhjeve për fleksibilitet (përfshirë sistemet me bateri dhe teknologji të tjera). Në këtë mënyrë do të sigurohet një rrjet.

PROJEKTE

MEPSO PJESË E FAMILJES SË JAO

Shkruan: Vanço Shahpaski el.inxh,
Dispeqer kryesor ne OEEC

Nga 1 janari 2026, pasi ShA MEPSO zyrtarisht u bë pjesë e Shtëpisë së vetme të alokimit të BE-së – Joint Allocation Office (JAO) filloi zbatimi i plotë i rregullave të reja për alokimet afatgjata (vjetore dhe mujore) dhe afatshkurtra (ditore) të kapaciteteve të transmetimit ndërkufitar në kufijtë MEPSO–ESO Bullgari dhe MEPSO–EMS Serbi.

Rezultatet fillestare nga zbatimi i këtij modeli tregojnë se janë përmbushur të gjitha pritshmëritë financiare të planifikuara nga alokimet e kapaciteteve, si dhe efektet financiare negative të pritura të lidhura me zbatimin e mekanizmit CBAM.

Përfitimet e MEPSO-s nga kjo mënyrë e realizimit të alokimit të kapaciteteve janë:rritje e stabilitetit financiar, parashikueshmëri më e madhe, harmonizim i plotë me rregulloret dhe praktikat evropiane dhe siguri kibernetike më e lartë.
Kështu konfirmohet edhe orientimi strategjik i MEPSO-s drejt integrimit në tregun evropian të energjisë elektrike. Nga këndvështrimi i pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike, modeli i ri ofron mundësi dhe liri më të mëdha, si dhe kufizime më të vogla në lidhje me disponueshmërinë dhe tregtimin e kapaciteteve ndërkufitare.

Procesi i anëtarësimit në JAO, të cilin MEPSO e zhvilloi në koordinim të ngushtë me operatorët nga Bullgaria dhe Serbia, zgjati më pak se një vit dhe përfshiu disa faza. Pas braktisjes së koordinuar të modelit të mëparshëm bilateral të alokimit (të bazuar në marrëveshje reciproke dhe zgjidhje lokale softuerike), pasuan: paraqitja e kërkesës për anëtarësim në JAO, formalizimi i bashkëpunimit, punë intensive e ekipeve teknike për harmonizimin e rregullave të alokimit dhe përgatitjen e sistemeve IT për shkëmbimin e të dhënave me platformën e JAO.



Faktor kyç për anëtarësimin e MEPSO-s në JAO ishte edhe miratimi i Harmonised Allocation Rules (HAR), të dorëzuara dhe miratuara nga ACER dhe të aprovuara nga Komisioni Rregullator për Energjetikë. Këto rregulla janë plotësisht në përputhje me Rregulloren e Komisionit (BE) 2016/1719 për Forward Capacity Allocation dhe lejojnë që minimumi 70% e kapacitetit të transmetimit të disponueshëm të ofrohet në ankande.

Realizimi i ankandeve filloi më 17 dhjetor me ankandin vjetor për kapacitetet ndërkufitare pasuar nga ankandet mujore ndërsa nga 31 dhjetori ankandet ditore zhvillohen në bazë të rregullt, çdo ditë.

Në drejtim të forcimit të integrimit rajonal dhe evropian, MEPSO vazhdon aktivitetet dhe harmonizimet me operatorin e Republikës së Greqisë – IPTO, me pritshmëri se gjatë vitit të ardhshëm edhe ankandet në kufirin Maqedoni–Greqi do të realizohen përmes JAO.

PROJEKTE me interes për komunitetin e energjisë(PECI)

MEPSO KA APLIKUAR PËR MARRJEN E STATUSIT PECI PËR PROJEKTIN "KORIDORI INTERKONEKTIV 400 KV LINDJE-PERENDIM,SEKSIONI PERENDIMOR

Pergatiti: m-r Branka Vasiq, MBA inxhinier pergjegjes per planiifkim strategjik

Projektet me interes për Komunitetin e Energjisë (Projects of Energy Community Interest – PECI) përfaqësojnë projekte prioritare infrastrukturore në fushën e energjisë elektrike dhe gazit, të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në më shumë se një shtet anëtar të Komunitetit të Energjisë. Ato përcaktohen me qëllim mbështetjen e zhvillimit të një tregu rajonal të integruar të energjisë, rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit me energji, si dhe mundësimin e integrimit efikas dhe të sigurt të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, në përputhje me objektivat e dekarbonizimit dhe tranzicionit energjetik.

Projektet PECI identifikohen përmes një procesi të përbashkët rajonal, të koordinuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, gjatë të cilit vlerësohen përfitimet e tyre teknike, ekonomike, mjedisore dhe të tregut. Një kriter kyç për përzgjedhjen e tyre është ndikimi ndërkufitar, përkatësisht aftësia e projektit për të kontribuar në përmirësimin e ndërlidhjes së sistemeve kombëtare energjetike, uljen e kufizimeve të rrjetit dhe përmirësimin e stabilitetit të të gjithë sistemit rajonal energjetik.
Dhënia e statusit PECI përfaqëson një njohje zyrtare të rëndësisë strategjike të projektit dhe mundëson koordinim institucional të përmirësuar ndërmjet vendeve pjesëmarrëse, përgatitje dhe zbatim më të shpejtë të projekteve, si dhe qasje të lehtësuar në instrumente financiare ndërkombëtare, asistencë teknike dhe mbështetje nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Roli I MEPSO-s dhe aplikimi per statutin PECI

SHA MEPSO, si operatori kombëtar i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ka një rol kyç në planifikimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi transmetimi të sigurt dhe të qëndrueshëm, të harmonizuar me politikat energjetike rajonale dhe evropiane. Në kuadër të aktiviteteve të saj strategjike, MEPSO punon vazhdimisht në forcimin e interkoneksioneve ndërkufitare dhe modernizimin e rrjetit të transmetimit, me qëllim integrimin më të mirë të tregut kombëtar të energjisë elektrike në tregun rajonal dhe evropian.
Në këtë drejtim, MEPSO ka aplikuar për marrjen e statusit PECI për projektin "Korridori interkonektiv 400 kV Lindje–Perëndim, Seksioni Perëndimor", duke vlerësuar se ky projekt ka rëndësi të theksuar rajonale dhe kontribuon drejtpërdrejt në realizimin e objektivave të Komunitetit të Energjisë, si dhe të objektivave kombëtare për furnizim të sigurt dhe të qëndrueshëm me energji elektrike.

Përshkrim i detajuar i projektit

Projekti Korridori interkonektiv 400 kV Lindje–Perëndim, Seksioni Perëndimor përfshin ndërtimin e një linje të re interkonektive të transmetimit 400 kV Tetovë–Prizren, e cila do të forcojë rrjetin e brendshëm të transmetimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do të vendosë një lidhje të re të drejtpërdrejtë elektroenergjetike me sistemin e Kosovës. Korridori lidh Shkupin dhe Ohërin përmes

Tetovës, me interkoneksion ndërkufitar drejt Prizrenit (Kosovë), ndërsa gjatësia e përgjithshme e Seksionit Perëndimor vlerësohet rreth 255 km.

Projekti është i strukturuar si një paketë investimesh të ndërlidhura që përfshin ndërtimin e linjave të reja të transmetimit 400 kV, ndërtimin e nënstacioneve të reja transformuese 400/110 kV, si dhe zgjerimin dhe përshtatjen e linjave ekzistuese të transmetimit. Një element kyç i projektit është ndërtimi i një nënstacioni të ri transformues 400/110 kV në Tetovë, i cili do të shërbejë si pikë qendrore për lidhjen e disa linjave 400 kV dhe do të mundësojë një rritje të ndjeshme të kapacitetit të transmetimit në pjesën perëndimore të vendit.

Për më tepër, projekti parashikon mundësinë e ndërtimit të një nënstacioni të ri transformues 400/110 kV në Oslomej, i cili do të mundësonte integrim më të mirë të kapaciteteve ekzistuese dhe të planifikuara të prodhimit, përfshirë edhe burimet e ripërtëritshme të energjisë, si dhe fleksibilitet më të madh operacional të sistemit.

Dimensioni rajonal dhe komplementariteti

Interkoneksioni i ri 400 kV Tetovë–Prizren përfaqëson një hallkë të rëndësishme në korridorin rajonal Lindje–Perëndim dhe mundëson forcimin e ndërlidhjes ndërkufitare ndërmjet Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Shqipërisë. Projekti është drejtpërdrejt komplementar me projektin tashmë të miratuar PECI për përmirësimin e korridorit të transmetimit Kosovë–Shqipëri (Prizren–Fierzë) në nivel tensioni 400 kV, duke formuar së bashku një korridor rajonal transmetimi të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm.
Kjo qasje e integruar mundëson flukse energjetike të sigurta dhe fleksibile në kuadër të Ballkanit Perëndimor, shfrytëzim më të mirë të kapaciteteve ekzistuese dhe të ardhshme të prodhimit, si dhe rritje të qëndrueshmërisë së sistemit të transmetimit përballë çrregullimeve dhe kushteve ekstreme operative.

Përfitimet e pritshme nga projekti

Realizimi i projektit do të sjellë një sërë përfitimesh në nivel kombëtar dhe rajonal, ndër të cilat:

- përmirësim i ndjeshëm i sigurisë dhe stabilitetit të sistemit të transmetimit;
- rritje e tregtisë ndërkufitare të energjisë elektrike dhe integrim më i mirë i tregut;
- reduktim i kufizimeve të rrjetit dhe përmirësim i fleksibilitetit operacional;
- krijim i kushteve për integrimin e kapaciteteve të mëdha nga burimet e ripërtëritshme të energjisë;
- mbështetje e objektivave afatgjata për dekarbonizim dhe zhvillim të qëndrueshëm të sektorit energjetik.

PROJEKTE

MEPSO PJESË E SOUTH EAST EUROPE CAPACITY CALCULATION REGION SEE CCR DHE PËRDORUESE E SHËRBIMEVE SELENE CC SI REGIONAL COORDINATION CENTRE (RCC)

Shkruan: м-r Igor Stojanovski el.inxh, I diplomuar
Udheheqes i sherbimit te analizes se rrjetit,sigurise operacionale dhe legjislacionit

Paralelisht me zhvillimin e rregulloreve të Electricity Intagration Packige, MEPSO gjithashtu ndërmori hapa operacional dhe iu bashkua SEleNe CC. Që nga 1 nëntori, MEPSO ka bashkëpunuar në mënyrë aktive dhe të përditshme me SEleNe CC, duke shkëmbyer informacion mbi modelin e rrjetit, duke bërë llogaritje operacionale dhe, në përputhje me planin e bashkëpunimit të rënë dakord, janë mbajtur trajnime të SEleNe CC për inxhinierët e OST-së.

Në periudhën e kaluar, është krijuar një kanal komunikimi për shkëmbimin e të dhënave në përputhje me rekomandimet e ENTSO-e, një model rrjeti krijohet çdo ditë sipas ndryshimeve në orar dhe gjendjes së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike dhe i dorëzohet SEleNe CC.

Pas bashkimit të të gjitha modeleve individuale të rrjetit nga të gjithë operatorët e sistemit nën koordinimin e SEleNe CC, SEleNe CC krijon një model të përbashkët dhe bazuar në të dhënat nga modeli i përbashkët, bëhen llogaritjet e përbashkëta të sigurisë dhe llogaritet kapaciteti ndërkufitar.

Rezultatet e llogaritjeve dhe analizave të kryera janë në dispozicion të të gjithë operatorëve të sistemit të koordinuar nga SEleNe CC dhe bazuar në këto të dhëna, vlerësohet siguria e rrjetit elektrotransmetues.

Më e rëndësishmja, bashkimi me SEleNe CC është një hap tjetër përpara për MEPSO-n drejt procesit të integrimit të tregjeve të energjisë elektrike të Bashkimit Evropian, një proces për të cilin po përpiqemi dhe që duket më afër me çdo hap të përfunduar.

SELENE CC
SOUTHEAST ELECTRICITY NETWORK COORDINATION CENTER

SEleNe CC(*Southeast Electricity Network Coordination Center*) është një Qendër koordinimi rajonale (RCC) për Evropën Juglindore, e vendosur në Selanik, Greqi. Qendra u krijua nga Operatorët e sistemit të transmetimit (OST) të Greqisë (IPTO), Bullgarisë (ESO EAD), Italisë (Terna) dhe Rumanisë (Transelectrica), me qëllim përmirësimin e sigurisë, koordinimit dhe integrimit të sistemit rajonal të energjisë elektrike.

Detyrat kryesore të SEleNe janë:

• Analiza e koordinuar e sigurisë së rrjetit

• Planifikimi dhe koordinimi I ndërprerjeve të kapaciteteve të ndërlidhura të transmetimit

• Llogaritja e koordinuar e kapaciteteve të transmetimit

• Parashikimi afatshkurtër i mjaftueshmërisë

• Modelimi i modeleve të rrjetit të përbashkët dhe individual

SEleNe CC është RCC-ja e fundit e themeluar në Evropë (pas Coreso, TSCNET, SCC, Nordic, Baltic), me qëllim përputhshmërinë e plotë me kuadrin rregullator evropian dhe integrimin e burimeve të rinovueshme dhe rrjedhave ndërkufitare të energjisë.

Me vendimin e ACER (*Agjencia për bashkëpunim të rregullatorëve energjetik*) të datës 16.12.2025 për përcaktimin e rajoneve të llogaritjes së kapaciteteve (*Capacity Calculation Regions – CCR*), u zgjerua South East Europe Capacity Calculation Region (*SEE CCR*) duke përfshirë operatorët e sistemeve të transmetimit nga Komuniteti energjetik, pra Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Kosova. Në këtë mënyrë, MEPSO filloi zyrtarisht procesin ligjor të zbatimit të dispozitave të rregullores CACM si bazë për zhvillimin e lidhjes së tregjeve (*market coupling – SDAC dhe IDAC*).

PROJEKTE

MEPSO ME STUDIMIN E PARË NACIONAL PËR ADEKUATSHMËRINË E BURIMEVE,NË PËRPUTHJE ME STANDARDET EVROPIANE

Për herë të parë, sistemi elektroenergjetik i Maqedonisë ka një vlerësim të plotë dhe metodologjikisht të avancuar të adekuatshmërisë së burimeve, i përgatitur plotësisht në përputhje me metodologjinë evropiane të ENTSO-E për European Resource Adequacy Assessment (ERAA). Studimi është realizuar nga Shërbimi për planifikim strategjik dhe analiza zhvillimore pranë ShA MEPSO, dhe autorët e tij janë Sime Kuzareski dhe Branka Vasiq. Ky studim përfaqëson një hap të rëndësishëm përpara në planifikimin strategjik dhe forcimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në dallim nga qasjet tradicionale deterministe, studimi i ri aplikon metodologji probabilistike bazuar në modelim të tregut me Antares dhe simulime Monte Carlo, duke analizuar më shumë se 37 milionë gjendje të mundshme të ardhshme të sistemit. Në analizë janë përfshirë kushtet klimatike, variabiliteti i burimeve të rinovueshme, ndërprerjet e detyruara të kapaciteteve prodhuese, si dhe mundësitë për shkëmbim ndërkufitar brenda sistemit panevropian elektroenergjetik.

Vlera e veçantë e studimit qëndron në integrimin e plotë rajonal: sistemi I Maqedonisë është modeluar në detaje në kontekstin panevropian, së bashku me 34 vende të tjera. Kjo qasje lejon vlerësim realist të rreziqeve nga mungesa e energjisë elektrike dhe thekson rolin e interkoneksioneve dhe gjeneratorëve fleksibël / burimeve, si centralet me gaz, hidrocentralet pompuese-akumuluese, magazinat e energjisë elektrike dhe burime të tjera të fleksibilitetit të sistemit – veçanërisht në kushtet e rritjes së pjesëmarrjes së burimeve të rinovueshme dhe tranzicionit të përshpejtuar energjetik.



Përgatitja e studimit u realizua në bashkëpunim të ngushtë me RTE International, degën ndërkombëtare të operatorit francez të sistemit të transmetimit RTE, në kuadër të një projekti të financuar nga Agjencia franceze e zhvillimit (AFD). Ky partneritet mundësoi transferimin e njohurive dhe implementimin e mjeteve dhe praktikave moderne që përdoren nga operatorët më të avancuar evropianë.

Me këtë studim, MEPSO jo vetëm që plotëson detyrimin ligjor, por vendos një bazë solide analitike për vendimet e ardhshme në lidhje me zhvillimin e kapaciteteve prodhuese, integrimin e burimeve të rinovueshme dhe forcimin e sigurisë së furnizimit – duke konfirmuar rolin kyç të saj në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të sistemit elektroenergjetik të vendit..

TS MANASTIR 2 – NYJA KRYESORE ENERGETIKE E SISTEMIT ELEKTROTRANSMETUES TË MAQEDONISË

Pergatiti; Irina Daskallova Qosevska

Trafostacioni Manastir 2 për më shumë se katër dekada ka qenë një nga shtyllat më të rëndësishme të sistemit elektroenergjetik të Maqedonisë. Ai luan rol kyç në transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar në KME Manastir – prodhuesi më i madh i energjisë elektrike në vend – drejt konsumatorëve në Maqedoni dhe drejt sistemeve fqinje elektroenergjetike.

Trafostacioni u vu në punë më 4 nëntor 1982, njëkohësisht me nisjen e punës së bllokut të parë KME Manastir, duke krijuar kështu bazën e qëndrueshme për zhvillimin e infrastrukturës elektroenergjetike në të gjithë shtetin.

"TS Manastir 2 që nga fillimi ka pasur rol strategjik. Është lidhja midis prodhimit dhe transmetimit të energjisë elektrike dhe pa të sistemi nuk do të mund të funksiononte në këtë nivel", thekson drejtori i trafostacionit, Vasil Maçevski, i cili prej 35 vitesh punon në kompani.

Karakteristikat teknike dhe nivelet e tensionit

TTS Manastir 2 paraqet një model specifik dhe unik të trafostacionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sepse është i lidhur me TE Manastir në dy nivele tensioni: në nivelin 400 kV përmes Bllokut 2 dhe Bllokut 3, si dhe në nivelin 110 kV përmes Bllokut 1.

Kjo e bën atë një lloj ure midis prodhimit dhe transmetimit të energjisë elektrike.

Transformimi kryhet me dy transformatorë 400/110 kV me fuqi të instaluar 300 MVA secili, të cilët mund të punojnë paralel sipas nevojës.

Nga ky trafostacion niset një nga lidhjet kryesore të tensionit të lartë të rrjetit elektrik – linja 400 kV TS Manastir 2 – TS Meliti, e cila lidh Maqedoninë me sistemin elektroenergjetik të Greqisë.

Në periudhën e ardhshme, ky trafostacion do të bëhet pikënisje kyçe edhe për interkoneksionin e ri 400 kV me Shqipërinë, si pjesë e korridorit më të gjerë rajonal të interkoneksioneve.

Transformatori i ri – hap i rëndësishëm drejt një stabiliteti më të madh

Më 7 janar të këtij viti u vu zyrtarisht në punë transformatori i ri 400/110 kV, një nga ndërhyrjet teknike më të rëndësishme të viteve të fundit.

"Me këtë transformator kemi rritur ndjeshëm sigurinë e punës dhe kemi rinovuar infrastrukturën kyçe të nënstacionit. Kjo është investim që ndikon drejtpërdrejt në stabilitetin e të gjithë sistemit elektroenergjetik", thekson Maçevski

Pajisjet e reja mundësojnë kapacitet më të mirë, siguri operative të rritur dhe rezistencë më të lartë të sistemit ndaj mbingarkesave dhe situatave emergjente

Interkoneksioni rajonal dhe perspektiva energjetike evropiane

Projekti për ndërtimin e linjës së re 400 kV drejt Shqipërisë është një nga ndërhyrjet më të rëndësishme infrastrukturore të periudhës së fundit.

Ky projekt do të mundësojë:

- *згforcimin e lidhjeve rajonale,*
- *rritjen e rezistencës së rrjetit të transmetimit,*
- *integrimin më të lehtë të burimeve të rinovueshme të energjisë,*
- *lidhje më të mirë me tregjet evropiane të energjisë elektrike.*

HFurnizimi me energji i Manastirit, Pellagonisë dhe rajonit më të gjerë

Përmes nivelit të tensionit 110 kV, TS Manastir 2 furnizon me energji elektrike:

- qytetin e Manastirit dhe vendbanimet përreth,,
- rajonin e Prilepit,
- pjesë të Prespës,
- kapacitete industriale, miniera, objekte bujqësore dhe ekonomike në Pellagoni..

Nga ky trafostacion energjia elektrike transmetohet drejt trafostacioneve të tjera, ku transformohet në 35, 10 dhe 0,4 kV, pas së cilës shpërndahet te konsumatorët përfundimtarë.

Organizimi, mbikëqyrja dhe siguria në punë

KFurnizimi i vazhdueshëm dhe i sigurt sigurohet përmes kombinimit të masave operative dhe organizative. Si objekt jashtëzakonisht strategjik, TS Manastir 2 është nën mbikëqyrje të vazhdueshme 24/7 nga ekipi i punonjësve që kujdesen për funksionimin e saktë dhe të pandërprerë të trafostacioit.

Ekipi përbëhet nga njerëz me përvojë, të trajnuar dhe të përkushtuar, të cilët janë të pranishëm ditë e natë dhe në çdo moment janë gati të reagojnë saktë dhe në kohë – tipar kyç në objekte të tilla për të parandaluar dëmet dhe pasojat për MEPSO-n dhe për të gjithë sistemin elektroenergjetik.

"Sistemi kërkon vëmendje të vazhdueshme. Çdo ditë monitorohen parametrat dhe reagohet në kohë për të mos pasur ndërprerje", shpjegon Maçevski

Roli në situata emergjente dhe rëndësia e sigurisë

Siguria në punë është prioritet absolut në TS Manastir 2. Zbatohen procedura të rrepta, protokolle të qarta dhe trajnime të vazhdueshme të personelit.

Në kushte emergjente, trafostacioni ka rol kyç në:

- mbrojtjen e rrjetit të transmetimit,

•stabilizimin e tensionit dhe frekuencës,

•sigurimin e rezervës,

•rikuperimin e shpejtë dhe efikas të sistemit.

Mesazh për inxhinierët e rinj

Me dekada përvojë pas vetes, Vasil Maçevski ka një mesazh të qartë për të rinjtë që mendojnë për karrierë në fushën e energjetikës:

Nëse doni profesion ku çdo ditë mësoni diçka të re, ku puna juaj ka ndikim real dhe doni të jeni pjesë e 'shtyllës së fshehur' të shoqërisë, atëherë puna në një trafostacion është zgjedhje e shkëlqyer."

GRATË NË ENERGJETIKË

PUNA ME TENSION TË LARTE DHE PËRGJEGJESI EDHE MË TË MADHE : NJË HISTORI INXHINIERIKE PAS SIGURISË SË SISTEMIT

Interviste me Stanisllava Sokollovska-inxhinjere elektrike

Në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike nuk ka vend për improvizime. Çdo vendim, çdo skicë dhe çdo ndërhyrje në terren janë pjesë e një mozaiku kompleks, të cilit qëllimi përfundimtar është transmetimi i sigurt dhe i qëndrueshëm i energjisë elektrike. Pas kësaj sigurie punojnë njerëz me një nivel të lartë profesionalizmi dhe përkushtimi, të cilët çdo ditë punojnë me tension të lartë dhe me përgjegjësi edhe më të madhe.
*Në këtë intervistë, në kuadër të rubrikës "**Gratë në energjetikë**", flasim me kolegen tonë, Stanislava Sokolovska, inxhinjere elektrike dhe udhëheqëse e Shërbimit për Projektim pranë Departamentit për Revitalizimin e Linjave të Transmetimit dhe Pajisjeve të Tensionit të Lartë në SHA MEPSO. Ajo na tregon se si duket historia inxhinierike pas sigurisë së sistemit, çfarë roli ka projektimi në proceset e revitalizimit dhe modernizimit, si dhe për udhëheqjen femërore, e cila është thelbësisht e integruar në zemrën e rrjetit të transmetimit.*

Si duket rruga juaj profesionale deri te dhe brenda SHA MEPSO dhe cilat përvoja ju "përgatitën" për pozicionin udhëheqës në fushën e projektimit?

Si fëmijë ëndërroja të bëhesha profesor dhe të transmetoja njohuri tek gjeneratat e reja. Episodi i jetës t ime që më solli në rolin kryesor të inxhinieres elektrike do ta tregoj në një rast tjetër.

Përvojën e parë pune e fitova në SHA EMO – Ohër,ku punoja si projektuese e linjave të transmetimit. Atje u njoha me punën reale në terren dhe mësova rëndësinë e punës në ekip, përgjegjësinë dhe qasjen profesionale, gjë që më ndihmoi dukshëm për avancimin e mëtejshëm në karrierë.Më pas vazhdova zhvillimin profesional në SHA MEPSO, Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST), ku punova në Departamentin e Kontrollit Teknik, Mirëmbajtjes dhe Testimit të Nënstacioneve Transformuese, pra në Shërbimin për Testime. Në këtë shërbim fitova përvojë të konsiderueshme praktike dhe njohuri më të thella profesionale për objektet me tension të

lartë dhe sistemet elektroenergjetike.Sot punoj në Departamentin e Revitalizimit – Shërbimi për Dokumentacion Projektimi, ku hartohen projektet ekzekutive për pajisje me tension të lartë, konkretisht për çelësat dhe ndarësit në objektet elektroenergjetike. Në kuadër të Departamentit të Revitalizimit funksionojnë Shërbimi Elektro, Shërbimi për Dokumentacion Projektimi dhe Departamenti për Përgatitjen Ndërtimore të Nënstacioneve Transformuese. Departamenti ynë është përgjegjës për rikthimin në funksion dhe modernizimin e objekteve energjetike të OST-së, me qëllim sigurimin e operimit të tyre të qëndrueshëm dhe afatgjatë.

Çfarë do të thotë për ju të punoni në një Operator të Sistemit të Transmetimit, duke pasur parasysh përgjegjësinë që kjo sjell për sigurinë dhe stabilitetin e sistemit elektroenergjetik?

Të punosh në Operatorin e Sistemit të Transmetimit është një nder i madh, një sfidë, por edhe një përgjegjësi e madhe. Që nga dita e parë u përballa me sfida të jashtëzakonshme, por njëkohësisht fitoja njohuri dhe përvoja të reja, dhe pikërisht përmes atij punimi, këmbënguljeje dhe përkushtimi, ecuria ime profesionale më çoi deri te pozicioni aktual.Megjithatë, duhet të theksohet se ne, punonjësit e OST-së, mbajmë përgjegjësinë për të vazhduar atë që kolegët më me përvojë kanë ndërtuar dhe lënë pas gjatë viteve. Siç thonë disa nga kolegët e mi, këtu nuk ka vend për improvizim; punohet me tension të lartë që kërkon përgjegjësi të vazhdueshme, respektim të standardeve të larta teknike dhe të sigurisë, shkëmbim të njohurive dhe përvojave, si dhe ndjekje të tendencave botërore në modernizimin e sistemit elektroenergjetik (EES).

Siguria dhe stabiliteti i EES-së janë prioriteti ynë kryesor dhe, si i tillë, qëndron në qendër të aktiviteteve tona të përditshme, të planifikuara dhe të paplanifikuara, me qëllim të sigurohet një transmetim i sigurt i energjisë elektrike brenda vendit dhe në linjat e transmetimit me vendet fqinje.

Çfarë rol ka projektimi në proceset e revitalizimit të linjave të transmetimit dhe pajisjeve me tension të lartë, veçanërisht nga aspekti i sigurisë afatgjate operative? (Përshkruani ditën tuaj të punës?

Projektimi në proceset e revitalizimit të pajisjeve me tension të lartë përbën një fazë përfundimtare, por jashtëzakonisht të rëndësishme, ku të gjitha aktivitetet e realizuara dhe koordinimet në terren sistematizohen dhe dokumentohen në dokumentacionin projektues përkatës. Në nënstacionet transformuese të SHA MEPSO është instaluar pajisje me tension të lartë nga prodhues të ndryshëm, si Siemens, Rade Končar, ABB, Alstom dhe të tjerë.Edhe pse çelësat dhe ndarësit kanë funksionin e tyre bazë, ata ndryshojnë për sa i përket lidhjeve sekondare dhe mënyrës së transmetimit të informacionit komandues dhe sinjalizues. Pikërisht kjo "lojë e kontakteve", siç thonë shpesh kolegët e mi, është një proces kompleks që kërkon ekspertizë të lartë, në mënyrë që e gjithë pajisja të funksionojë pa probleme dhe nënstacioni të lihet në një gjendje plotësisht të sigurt.

Procesi fillon me informacionet e marra nga Departamenti i Kontrollit Teknik, Mirëmbajtjes dhe Testimit të Nënstacioneve Transformuese, mbi bazën e të cilave përcaktohet gjendja e elementeve në nënstacion.

Në koordinim me ta, identifikohen elementët prioritare për zëvendësim (çelësat, ndarësit etj.)

Më pas, në varësi të mundësive për ndërprerje të furnizimit dhe gjendjes aktuale të sistemit

elektroenergjetik, realizohet çmontimi i pajisjes së vjetër dhe montimi i pajisjes së re.

Dita zakonisht fillon me një koordinim të shkurtër në zyrë, ku ekipi i Departamentit të Revitalizimit shqyrton agjendën ditore dhe përparimin e projekteve.

Kontrollohen planet ekzekutive për pajisjet me tension të lartë, siç janë çelësat dhe ndarësit, dhe përcaktohen prioritetet për punën në terren. Pas kontrollit në terren, ndiqet përgatitja e versioneve të punës të projekteve dhe, kur gjithçka është hartuar, krijohet projekti i gjendjes së realizuar.

Çdo projekt ekzekutiv kontrollohet dhe dokumentohet, dhe shpesh organizohen edhe takime koordinuese me departamente të tjera, Shërbimin Elektro dhe Departamentin për Përgatitjen Ndërtimore, për të sinkronizuar

aktivitetet dhe për të planifikuar hapat e ardhshëm.

Cilat janë sfidat teknike më të shpeshta me të cilat përballeni gjatë revitalizimit dhe modernizimit të infrastrukturës ekzistuese të transmetimit me jetëgjatësi të gjatë?

Si balançohet nevoja për vazhdimësi të transmetimit me kërkesën për modernizim dhe ndërhyrje në rrjet?

Sfidat teknike më të shpeshta gjatë revitalizimit të infrastrukturës së transmetimit me jetëgjatësi të gjatë lidhen me teknologjinë e vjetër, humbjet teknike të larta dhe integrimin e kufizuar të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Vazhdimësia e transmetimit balançohet me modernizimin përmes implementimit të projekteve në faza, përdorimit të kapaciteteve rezervë dhe interkoneksioneve me sistemet fqinje, si dhe përmes përdorimit të pajisjeve të reja dixhitale për monitorim dhe menaxhim.

Sa ndikojnë standardet ndërkombëtare, koordinimi rajonal dhe rekomandimet e ENTSO-E mbi zgjidhjet projektuale në MEPSO?

Standardet ndërkombëtare, koordinimi rajonal dhe rekomandimet e ENTSO-E kanë një ndikim thelbësor mbi zgjidhjet projektuale të SHA MEPSO, pasi ato përcaktojnë kornizën për sigurinë dhe integrimin e sistemit të transmetimit maqedonas në rrjetin energjetik evropian. MEPSO duhet të ndjekë direktivat për efikasitet energjetik, burime të ripërtëritshme dhe dekarbonizim.

Projektet për linja të reja transmetimi dhe nënstacione transformuese planifikohen në përputhje me operatorët rajonalë të sistemeve, për të shmangur ngushtësitë në rrjet dhe për të rritur kapacitetin për tregti ndërkufitare. MEPSO gjithashtu merr pjesë në plane të përbashkëta për integrimin e burimeve të ripërtëritshme dhe për rritjen e sigurisë së furnizimit.

Në këtë mënyrë, përfundimisht konkludojmë se SHA MEPSO nuk mund të planifikojë dhe realizojë projekte në mënyrë të izoluar – çdo zgjidhje duhet të jetë e harmonizuar me standardet evropiane dhe nevojat rajonale,

duke siguruar integrimin e ardhshëm të sistemit maqedonas në Komunitetin Evropian të Energjisë.

Çfarë rol ka revitalizimi i linjave të transmetimit në kontekstin e integrimit të shtuar të burimeve të ripërtëritshme dhe transmetimit ndërkufitar? Dhe sa ndryshojnë mjetet digjitale, zgjidhjet e avancuara softuerike dhe analizat e gjendjes së pajisjeve qasjen ndaj projektimit?

Revitalizimi i linjave të transmetimit është një kusht paraprak për integrimin e burimeve të ripërtëritshme dhe tregtinë ndërkufitare, ndërsa mjetet digjitale dhe analizat që përdor SHA MEPSO po transformojnë qasjen inxhinierike, nga modeli tradicional drejt një modeli bashkëkohor të menaxhimit të bazuar në të dhëna dhe parashikues. Revitalizimi i linjave të transmetimit është një proces strategjik që ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi integrimin e burimeve të ripërtëritshme, transmetimin ndërkufitar dhe sigurinë e fleksibilitetin e sistemit të transmetimit. SHA MEPSO po ndryshon gradualisht qasjen ndaj projektimit, përmes dixhitalizimit të vazhdueshëm, i cili aktualisht është i implementuar në të gjithë sektorët e kompanisë.

Sa e rëndësishme është puna në ekip, transferimi i njohurive, kultura korporative dhe mbështetja institucionale për ruajtjen e standardeve të larta profesionale në inxhinierinë elektrike, dhe cila do të ishte mesazhi juaj për inxhinierët e rinj, veçanërisht për gratë që e shohin karrierën e tyre në energjetikë?

Në energjetikë, ekspertiza teknike vetë nuk është e mjaftueshme; sistemet janë komplekse dhe kërkojnë koordinim të vazhdueshëm mes inxhinierëve, operatorëve, regulatorëve dhe institucioneve të tjera të përfshira. Prandaj, puna në ekip është thelbësore, pasi lejon zgjidhje më të shpejta të problemeve të mundshme, reduktim të rreziqeve dhe transfer më të shpejtë të njohurive.

Inxhinierët me përvojë mund të jenë udhërrëfyes dhe frymëzim, por duhet të transmetojnë njohuritë praktike te gjeneratat e reja. Kjo është kyçe për vazhdimësinë e punës dhe për shmangien e gabimeve të mëparshme.

Mesazhi im për inxhinierët e rinj, veçanërisht për koleget, është të mos kenë frikë nga sfidat, sepse njohuria teknike është një gjuhë universale, pa marrë parasysh gjininë apo moshën. Vlerësoni ekipin përreth jush, sepse njohuria kolektive është shumë më e madhe se ajo individuale, dhe vetëm kështu mund të zgjidhen sfidat në mënyrë të përbashkët; më e rëndësishmja, puna në ekip krijon projekte që

një individ nuk mund t'i realizojë kurrë vetëm. Dhe në fund, mos kini frikë të gaboni – kini frikë të mos mësoni asgjë nga gabimet

SCADA: VENDI KU TEKNOLOGJIA DHE PERGJEGJESIA PUNOJNE 24/7

Pergatiti: Irina Daskallovska Qosevska

Kur përmendet SCADA, për shumëkënd është thjesht një akronim teknik tjetër. Por në ShA MEPSO, SCADA është "sistemi i gjallë" që 24 orë në ditë monitoron gjendjen e rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike dhe mundëson që ai të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme dhe të sigurt. Pikërisht këtu fillon dita jonë me Mia Buralieva, drejtuese e Departamentit për Informatikë Teknike.

"SCADA është akronim nga Supervisory Control and Data Acquisition. Përmes tij kryejmë mbikëqyrje të rrymave, tensioneve, frekuencës, fuqisë aktive dhe reaktive, alarmeve të tjera dhe statusit të pajisjeve të tensionit të lartë, si dhe menaxhim të pajisjeve primare," shpjegon ajo.

Por SCADA është vetëm pjesë e sistemeve komplekse të mbikëqyrjes dhe menaxhimit në NDC (Qendra Nacionale e Dispetcherimit) dhe objektet e rrjetit elektroenergjetik. Në Qendrën Nacionale të Dispetcherimit, MEPSO disponon sistemin SCADA/EMS – SCADA dhe Energy Management System, softuerë të specializuar për nevojat e operatorëve të sistemeve të transmetimit. Ky sistem përfshin aplikacione rrjetore, AGC (Automatic Generation Control), simulatorë për trajnimin e dispetcherëve, si dhe shkëmbim të vazhdueshëm të të dhënave operative me objektet elektroenergjetike, sistemet e shkëmbimit të të dhënave të ENTSO-E dhe operatorët e tjerë të sistemeve të transmetimit. Paralelisht me këtë, në pjesën më të madhe të nënstacioneve funksionojnë sisteme lokale të mbikëqyrjes dhe menaxhimit, të bazuara në pajisje RTU (Remote Terminal Unit) ose sisteme SCADA/BCU (Bay Control Unit), të cilat në kohë reale i sigurojnë dhe i dërgojnë të dhënat në sistemin SCADA/EMS në NDC.

"Gjithçka duhet të funksionojë në kohë reale, 24/7, sepse kjo është kusht paraprak për sigurinë dhe besueshmërinë e rrjetit të transmetimit. Sistemet që përdorim janë moderne dhe plotësisht në përputhje me trendet botërore," shton Buralieva.,

Si duket dita e punës në qendrën SCADA

PDita e punës në qendrën SCADA zakonisht fillon me kontrollin e sistemeve, funksionalitetin e serverëve, komunikimeve dhe interkoneksioneve. Kontrollohen matjet, statuset, alarimet dhe të dhënat nga nënstacionet, pas së cilës vijon koordinimi i aktiviteteve në terren. Edhe pse nuk ka orë kritike gjatë ditës, ekzistojnë kushte kritike. Temperaturat ekstremisht të larta verore dhe ato të ulëta dimërore janë sfidë serioze për pajisjet dhe sistemet që duhet të punojnë pa ndërprerje. "*Ditë e qetë? Shumë rrallë*," buzëqesh Buralieva.

"Edhe kur nuk ka intervenime, gjithmonë ka aktivitete të tjera, dhe shpesh pikërisht para festave ose fundjavave, kur dëshirojmë qetësi dhe paqe, shfaqet ndonjë sfidë e papritur."

Ekip i vogël, përgjegjësi e madhe

Departamenti për Informatikë Teknike është i organizuar në tre shërbime: shërbimi për SCADA/EMS, shërbimi për sistemet e mbikëqyrjes dhe menaxhimit të objekteve elektroenergjetike dhe shërbimi për sistemet teleinformatike. Detyra primare është që të gjitha sistemet në qendrën e dispetcherimit, sallën e sistemeve dhe nënstacionet ku kemi menaxhim, të jenë funksionale 24/7, 365 ditë në vit. Paralelisht me këtë, kryhen përmirësime, zgjerime, prokurime dhe instalime të moduleve ose sistemeve të reja, ndjekje e trendeve për zgjidhje dhe teknologji të reja teknike në fushë, metoda moderne në eksploatim dhe mirëmbajtje. Por numri i punonjësve është dukshëm më i vogël krahasuar me operatorët e tjerë të sistemeve.

"Kemi vetëm dy inxhinierë për sistemet teleinformatike dhe tre në shërbimin për SCADA/EMS. Shpesh bëjmë punë që formalisht nuk na takojnë, dhe pikërisht për këtë jam jashtëzakonisht mirënjohëse ndaj kolegëve," thotë Buralieva..

Diçka që nuk harrohet

Veçanërisht e gjallë është kujtesa për prokurimin dhe implementimin e sistemit të parë SCADA/EMS në vitin 2001. *"Filluam nga zero, duke futur të dhëna për nënstacionet, linjat e transmetimit dhe kapacitetet prodhuese. Nënstacionin e parë e futëm për javë të tëra, pastaj, me përvojën e fituar, arrinim të aktivizonim edhe disa në ditë. Momenti kur vizatuam hartën e të gjithë Maqedonisë së Veriut dhe në kohë reale morëm të dhënat e para nga nënstacionet dhe hidrocentralet, ishte i paçmuar."*

Kur alarimet nuk duhet të injorohen

Sistemet e mbikëqyrjes dhe menaxhimit kanë rol kyç në ruajtjen e stabilitetit të sistemit elektroenergjetik. Falë mbikëqyrjes në kohë reale, zbulimit të hershëm të anomalive dhe mbështetjes në marrjen e vendimeve

problemet shpesh zbulohen para se të kthehen në defekte serioze. Kur sistemi alarmon, operatorët në NDC reagojnë ndaj alarmeve nga objektet, ndërsa ekipi i Buralievës fokusohet te alarimet sistemike.



Çdo rast është i ndryshëm. Ndonjëherë zgjidhja gjendet për pesë minuta, ndonjëherë për disa orë. Si persona teknikë gjithmonë duam të kemi shpjegim logjik për shkakun që e ka shkaktuar problemin, por me softuerët nuk është gjithmonë kështu. Kjo e bën punën tonë komplekse, por edhe sfiduese."

dër sfidat më të reja është defekti i sistemit UPS, kur në Pashkë në mesnatë, Drejtoria dhe sistemi SCADA/EMS mbetën pa furnizim me energji. Falë përvojave dhe aktiviteteve të ndërmarra për rikthimin e funksionaliteteve kyçe pas këtij incidenti, reagimi gjatë incidentit të 18 majit 2025 ishte ndjeshëm më i shpejtë.

Teknologjia funksionon, sepse njerëzit bashkëpunojnë

Edhe pse puna kërkon përqendrim të madh, faktori kyç është puna ekipore. "Mes kolegëve nga ОЕПС vlen rregulli i pashkruar: ndërsa të tjerët punojnë, të tjerët heshtin. Pa punë ekipore nuk ka as heqje defekti, as implementim të sistemit të ri," thotë Buralieva..

E ardhmja e sistemeve SCADA është e pandashme nga modernizimi, dixhitalizimi dhe automatizimi, si përgjigje ndaj decentralizimit, integrimit të burimeve të rinovueshme të energjisë, sigurisë kibernetike, dinamikës së shtuar të prodhimit/konsumit, kërkesave rregullatore... Teknologjitë e reja e lehtësojnë punën dhe mundësojnë marrje vendimesh më të shpejta dhe më precize.

Sa i përket gjeneratave të reja të inxhinierëve që vijnë, Buralieva ka një mesazh të qartë: *"Diploma është vetëm fillimi. Mësimi i vërtetë fillon me punësimin dhe zgjat tërë karrierën, sepse njohuritë ndërtohen me punë, me pyetje dhe me përvojë."*

KONFERENCA, FORUME, DEBATE

MEPSO NË KONFERENCËN PËR DIGJITALIZIM TË ORGANIZUAR NGA AMCHAM

Në kuadër të konferencës vjetore për digjitalizim të Odës ekonomike amerikane (AmCham), u mbajt një panel-diskutim i dedikuar digjitalizimit dhe sigurisë kibernetike në sektorin energjetik. Bashkë me ekspertë nga KRrE, EVN, Cisco dhe Tessa Group, u diskutuan tema të lidhura me modernizimin e rrjeteve elektroenergjetike, implementimin e teknologjive smart-grid, monitorimin e avancuar digjital dhe sfidat nga rregulloret e reja ligjore. Vëmendje e veçantë iu kushtua mbrojtjes së infrastrukturës kritike energjetike, e cila përbën bazën për një sistem energjetik të sigurt, të qëndrueshëm dhe të sigurt.

MEPSO vazhdon të marrë pjesë aktive në proceset e transformimit digjital, duke kontribuar në rritjen e pjekurisë digjitale, sigurisë dhe efikasitetit të sektorit energjetik.

PUNËTORI INTERAKVITE PËR SFIDAT DHE RISITË NE PROKURIMET PUBLIKE

Gjatë muajit nëntor 2025, punonjësit e Sektorit për çështje financiare morën pjesë në një trajnim që u zhvillua në Gjevgjeli, ku nëpërmjet një puntore interaktive u shkëmbyen përvoja dhe u diskutuan çështje e dilema me të cilat përballen organet kontraktuese dhe operatorët ekonomikë gjatë planifikimit dhe zbatimit të procedurave të prokurimit publik, sfidat që hasen në përgatitjen e kushteve dhe kërkesave për hartimin e dokumentacionit të tenderit pas përmirësimeve të bëra në Sistemin elektronik të prokurimit publik (SEPP) që nga data 01.04.2025, si dhe çështjet lidhur me lidhjen dhe monitorimin e kontratave dhe ndryshimet e kontratave gjatë periudhës së vlefshmërisë së tyre.
Gjithashtu, në trajnim u shkëmbyen përvoja për zbatimin e ndryshimeve ligjore dhe përballimin me dobësitë dhe rreziqet më të shpeshta në praktikë gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

Trajnimi u organizua dhe u zhvillua nga një ekspert i certifikuar – trajner i autorizuar për prokurimin publik, me përvojë shumëvjeçare praktike në planifikimin, zbatimin e procedurave për dhënien e kontratave të prokurimit publik dhe në lidhjen e marrëveshjeve kornizë.

KONFERENCA, FORUME, DEBATE

SEKTORI I IT DHE TK-MBËSHTETJA DIGJITALE E SISTEMIT TË SIGURT ELEKTROTRANSMETUES

Në kushtet e dixhitalizimit të shpejtë dhe rreziqeve në rritje të sigurisë, sektori i IT-së dhe telekomunikacionit në ShA MEPSO luan një rol kyç në sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm dhe të sigurt të sistemit elektrotransmetues në të gjithë vendin. Si pjesë e infrastrukturës kritike, MEPSO vazhdon të investojë në zgjidhje teknologjike moderne, dhe sektori IT/TK është motori kryesor i transformimit digjital.

Njohuritë dhe përvoja – burime kyçe për stabilitetin digjital

Në periudhën e fundit, fokusi është vënë në avancimin e sistemeve të informacionit, infrastrukturës së rjetit dhe kapaciteteve telekomunikuese. Këto investime kontribuojnë në besueshmëri më të lartë, disponueshmëri dhe efikasitet të shërbimeve.

Rëndësi të veçantë në këto procese ka kapitali njerëzor – profesionistë të IT-së dhe sigurisë kibernetike të trajnuar lart, të cilët çdo ditë punojnë në mirëmbajtje, monitorim dhe mbrojtje të sistemeve nga kërcënimet e mundshme.

Disaster Recovery – projekt për rritjen e qëndrueshmërisë së sistemeve

Një nga projektet më të rëndësishme në vazhdim është krijimi dhe finalizimi i lokacionit të Disaster Recovery (DR). Me të, MEPSO rrit ndjeshëm gatishmërinë për t'u përballur me ngjarje të paparashikuara, defekte teknike ose incidente kibernetike

.Përfundimi i projektit pritet të jetë ka mesi i viti 2026 dhe do të përfaqësojë një hap të rëndësishëm për harmonizim me standardet më të larta ndërkombëtare për menaxhimin e rreziqeve dhe vazhdimësinë e biznesit.

Cibersecurity tabletop exercise- " BalkanSecure: Advancing Cybersecurity in the Western Balkans"

Përmes trajnimeve të vazhdueshme, certifikimeve dhe investimeve në burimet njerëzore, sektori IT dhe TK forcon pozicionin e tij si partner strategjik në zhvillimin e kompanisë, duke siguruar një bazë teknologjike të qëndrueshme për menaxhimin e sigurt dhe efikas të sistemit elektrotransmetues

Security Operations Center (SOC)

Përveç stabilitetit teknik, siguria kibernetike është një nga prioritetet strategjike të sektorit IT dhe TK në MEPSO.

Në kushtet e numrit në rritje të kërcënimeve kibernetike globale, nevojitet një qasje proaktive, monitorim i vazhdueshëm dhe reagim në kohë.

Kompania ka punonjës të dedikuar në fushën e sigurisë kibernetike, të cilët punojnë në zbatimin e politikave të sigurisë, sistemeve të detektimit dhe parandalimit, si dhe në ngritjen e ndërgjegjësimit për sigurinë tek të gjithë punonjësit..

Konferenca rajonale e mbajtur

në Prishtinë

Gjatë vitit 2026 planifikohet fillimi i aktiviteteve për krijimin e Security Operations Center (SOC) – një pikë e centralizuar për monitorim, analizë dhe menaxhim të ngjarjeve të sigurisë në kohë reale. SOC do të jetë një hap i madh përpara në mbrojtjen e infrastrukturës kritike IT dhe operative (OT) dhe do ta rrisë edhe më tej gatishmërinë e MEPSO-s për t'u përballur me incidente kibernetike komplekse.

Cranfield University

SecureD&Under control-IT konferenca në Slloveni

Siguria dhe

përgjegjësia shoqërore

Përveç sigurisë digjitale, MEPSO investon edhe në mbrojtjen fizike të punonjësve dhe objekteve. Në këtë drejtim, është planifikuar zbatimi i një sistemi për zbulim të hershëm të zjarreve, që do të mundësojë alarmim dhe parandalim në kohë, duke ulur ndjeshëm rrezikun e dëmeve dhe ndërprerjeve në punë.

Me vizion të qartë, qasje strategjike dhe ekip të përkushtuar, sektori IT dhe TK mbetet një shtyllë e rëndësishme në ndërtimin e një sistemi elektrotransmetues të sigurt, modern dhe të qëndrueshëm – në shërbim të qytetarëve dhe ekonomisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut

ORGANIZATA SINDIKALE E ShA MEPSO

PËRKUSHTIM PËR STANDARD MË TË LARTË DHE KUSHTE TË SIGURTA PUNE

Organizata sindikale e ShA MEPSO edhe në vitin 2026 vazhdon me punë sindikale të vendosur, të përgjegjshme dhe transparente, e udhëhequr nga qëllimi i qartë dhe i pandryshueshëm: përmirësimi i statusit ekonomik-social, siguria në punë dhe ngritja e standardit të përgjithshëm të jetesës së punonjësve.

Aktivitetet e planifikuara për vitin 2026 janë vazhdim logjik dhe i domosdoshëm i proceseve të nisura në vitin 2025 – një periudhë e shënuar nga rritje e ndjeshme e kostove të jetesës, presione të forta inflacioniste dhe sfida të mëdha ekzistenciale për punëtorët. Në këto kushte, Sindikata pati rol aktiv dhe të përgjegjshëm në harmonizimin e pagave, duke theksuar vazhdimisht nevojën për rregullim të rregullt dhe të drejtë të tyre, në përputhje me zhvillimet ekonomike dhe detyrimet ligjore.

Edhe në vitin 2026, prioriteti numër një mbetet përmirësimi i pagave dhe mbrojtja e fuqisë blerëse të punonjësve. Kjo do të arrihet përmes zbatimit të plotë dhe të qëndrueshëm të Marrëveshjes.

Kolektive, korrigjimit të pagës minimale në Shoqëri, shpërndarjes së drejtë, transparente dhe të barabartë të të ardhurave, si dhe sigurimit të kompensimeve të përshtatshme për punë me orar të zgjatur, punë nate dhe punë në terren.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet vazhdimisht sigurisë dhe shëndetit në punë, duke pasur parasysh se punonjësit e ShA MEPSO çdo ditë kryejnë detyra në kushte me rrezik të lartë dhe përgjegjësi të madhe. Organizata sindikale do të vazhdojë pa kompromis të kërkojë zbatimin e standardeve më të larta të sigurisë, trajnime të rregullta dhe cilësore për punë me energji elektrike dhe tension të lartë, furnizim në kohë me pajisje të plota mbrojtëse personale, si dhe organizimin e kontrolleve shëndetësore parandaluese dhe programe rehabilitimi.

Në drejtim të kujdesit për punonjësit dhe forcimit të solidaritetit sindikal, në vitin 2026 planifikohen aktivitete për ngritjen e mirëqenies, duke përfshirë organizimin e pushimeve parandaluese dhe rekreative, aktivitete sportive dhe kulturore sindikale, si dhe vazhdimin e bashkëpunimit sindikal rajonal dhe ndërkombëtar.

Sindikata e ShA MEPSO thotë qartë dhe me zë të lartë: punëtori nuk është shpenzim, por shtylla më e rëndësishme e një sistemi energjetik të qëndrueshëm, të sigurt dhe të stabil. Pa punën, njohuritë, ekspertizën dhe përkushtimin e tij nuk mund të sigurohet furnizim i sigurt dhe i pandërprerë me energji elektrike.

Edhe në vitin 2026, Sindikata e ShA MEPSO mbetet fort dhe pa lëkundje e përkushtuar në luftën për paga dinjitoze, kushte të sigurta pune dhe të ardhme të sigurt për të gjithë punonjësit e ShA MEPSO.

PUNONJËSIT DHE ShA MEPSO

Angelina Petreska është ekonomiste e diplomuar dhe udhëheqëse e njësisë organizative të Planifikimit dhe Analizës në Kabinetin e drejtorit gjeneral të MEPSO-s. Ajo u diplomua në Fakultetin Ekonomik "Shën Kirili dhe Metodi", Shkup, me degë financë, kontabilitet dhe bankë. Ajo e filloi karrierën e saj profesionale në departamentin e çështjeve financiare të NP Elektrostopanstvo na Makedonija. Në vitin 2002, me fillimin e liberalizimit të tregut, ajo u bashkua me Shërbimin e tregut të energjisë elektrike, dhe pas themelimit të ShA MEPSO në vitin 2005, ajo u bë udhëheqëse e Shërbimit të Planifikimit, Analizës dhe Sigurimit. Që nga viti 2019, njësia organizative e Planifikimit dhe Analizës funksionon në kuadër të Kabinetit të drejtorit gjeneral. Ajo merr pjesë në përgatitjen e planeve dhe raporteve financiare, në monitorimin dhe analizimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike dhe ka shumë vite përvojë në analizimin e të dhënave financiare dhe energjetiko-teknike të nevojshme për marrjen e vendimeve të ndryshme afariste. Ajo ka bashkëpunuar me disa institucione, organizata, komisione dhe organe, duke përfshirë Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Komisionin Rregullator Energjetik, ASO, etj.

Goran Taneski, është inxhinier i diplomuar pyjor me mbi 20 vjet përvojë pune, i punësuar në ShA MEPSO që nga themelimi i Shoqërisë.Karierën e ka filluar si inxhinier për mirëmbajtjen e korridoreve në Shërbimin për mirëmbajtjen e linjave të tensionit të lartë, pranë Njësisë së ORrt-së , ndërsa që nga viti 2019 punon si Udhëheqës i Shërbimit për mirëmbajtjen e korridoreve.Veprimtaria kryesore e Shërbimit është mirëmbajtja e korridoreve të linjave të tensionit 110 kV dhe 400 kV, që përfshin kontrollin dhe heqjen e vegjetacionit të rritur sipas kontrolleve periodike të linjave që kryhen nga ekipet e LP (ekipat e linjave të tensionit të lartë ose ekipet në terren). Pas çdo kontrolli, përcaktohen lokacionet prioritare për ndërhyrje me qëllim parandalimin e çdo ndërprerjeje të mundshme në funksionimin e linjave të tensionit të lartë, të cilat përbëjnë pjesë përbërëse të sistemit elektroenergjetik në vend.Punët në terren i kryejnë ekipet e specializuara nga Shkupi, Shtipi,Manastir dhe Ohër Taneski është përgjegjës për:Organizimin, koordinimin dhe kontrollin e ekipeve, prokurimin e mjeteve dhe pajisjeve të përshtatshme, trajnimet e vazhdueshme të punonjësve, njoftimin në kohë të pronarëve dhe personave që menaxhojnë pyjet për ndërhyrjet e planifikuara në korridore.Me organizim efikas të ekipit, sigurohet një sistem elektroenergjetik i besueshëm dhe i qëndrueshëm, pa ndërprerje të shkaktuara nga vegjetacioni

Gordana Andonovska – ekonomiste e diplomuar me 28 vjet përvojë pune në sektorin energjetikKarrierën e saj profesionale e ka nisur në vitin 1998 në sektorin e financave si referent i pavarur për planifikim dhe analizë në Elektro Shkup (në atë kohë Elektrostopanstvo e Maqedonisë).Në vitin 2003 kalon në Sektorin për zhvillim dhe investime si referent për çështje komerciale dhe financiare. Ajo merr pjesë aktive në implementimin e projekteve të financuara nga institucionet financiare ndërkombëtare. Është anëtare e disa grupeve punuese për përgatitjen e tenderëve, vlerësimin e ofertave dhe zbatimin e kontratave. Punon në projekte të financuara nga Banka Botërore dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Ajo vazhdimisht ndjek trajnime dhe punëtori në fushën e menaxhimit financiar të projekteve. Ka bashkëpunim të vazhdueshëm me Bankën Botërore, BERZH-in, si dhe me bankat tregtare në vend dhe Bankën Nacionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.Nga viti 2019 deri në vitin 2025 ajo ka qenë udhëheqëse e Shërbimit për bashkëpunim ndërkombëtar në ShA MEPSO.

Romeo Josifoski është një inxhinier i diplomuar elektrik me përvojë të gjatë në sektorin elektroenergjetik.Ai e ka filluar karrierën në kompaninë private për kryerjen e instalimeve elektrike „OM" ShPKNjP Shkup, si mbikëqyrës i ekzekutimit.Që nga viti 2006 e deri më sot, ai punon në ShA MEPSO.Në MEPSO ka ushtruar disa funksione profesionale dhe drejtuese, ndër të cilat:Udhëheqës operacional i Sistemit elektroenergjetik (SEE) në Njësinë e OST-së,Dispacher Kryesor,Udhëheqës i Shërbimit për planifikim operativ, dhe udhëheqës i Departamentit për operacione të tregut, në të cilin pozicion ndodhet edhe sot.Në periudhën 2010–2014 ka qenë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të ShA MEPSO. Ai posedon përvojë të pasur në punën me sistemet SCADA/EMS dhe MMS.Ka marrë pjesë aktive në hartimin e akteve të para ligjore dhe nënligjore gjatë liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, dhe kontributi i tij edhe sot vlerësohet dhe çmohet shumë lart..

Jasmina Angelska u diplomua në Fakultetin Juridik "Justiniani i Parë" në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup. Ajo e filloi karrierën e saj profesionale si avokate, ku me kalimin e viteve fitoi ekspertizë të konsiderueshme në fushën e së drejtës së punës dhe qeverisjes korporative. Që nga viti 2019, ajo ka mbajtur pozicionin e udhëheqëses së Departamentit të Burimeve Njerëzore në ShA MEPSO, ku punon në mënyrë aktive në zhvillimin dhe përmirësimin e politikave të personelit. Ajo i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të punonjësve dhe forcimit të kulturës organizative, duke kontribuar kështu në një menaxhim më efikas dhe strategjik të burimeve njerëzore. Si pjesë e punës së saj, ajo bashkëpunon me disa institucione, organizata, komisione dhe organe, duke përfshirë Ministrinë e Financave, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Energjetikës. Ajo është e përfshirë në mënyrë aktive në grupin e punës për rikualifikim dhe trajnim si pjesë e procesit të tranzicionit të drejtë. Me njohuritë dhe përvojën e saj, ajo përfaqëson një pjesë të rëndësishme të ekipit të ShA MEPSO, duke kontribuar në kryerjen në kohë dhe efikase të detyrave të punës brenda fushëveprimit të Departamentit të burimeve njerëzore.

Mafis Rushiti është një inxhinier i diplomuar në shkencat kompjuterike dhe udhëheqës i Shërbimit për shërbime informative infrastrukturore në sektorin IT-TK të ShA MEPSO.Ka një përvojë profesionale shumëvjeçare në fushën e teknologjive të informacionit, prej të cilave gjashtë vjet në ShA MEPSO, ku luan një rol të rëndësishëm në planifikimin, zhvillimin dhe avancimin e infrastrukturës IT të kompanisë.Puna e tij është drejtpërdrejt e lidhur me proceset e digitalizimit, modernizimit të sistemeve dhe sigurimin e një infrastrukture IT të qëndrueshme, të sigurt dhe me disponueshmëri të lartë.Si udhëheqës, ai menaxhon infrastrukturën e serverëve dhe rrjetit, qendrat e të dhënave (data centers) si dhe vazhdimësinë e operacioneve (business continuity).Ai merr pjesë aktive në implementimin dhe optimizimin e zgjidhjeve IT që janë në përputhje me standardet moderne dhe nevojat e kompanisë, dhe bashkëpunon me sukses me sektorët e tjerë për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm dhe efikas të infrastrukturës IT të ShA MEPSO

LAJME NGA BOTA

SHQIPËRIA NDËRTON PARKUN E SAJ TË PARË ME ERË

Shqipëria ka promovuar projektin për ndërtimin e parkut me erë të Tropojës, i cili do të ketë një kapacitet të instaluar prej 600 MW. Zbatimi i projektit është në duart e kompanisë amerikane CWP - një nga investitorët më të rëndësishëm në burimet e energjisë së rinovueshme në rajonin e Evropës Juglindore. Ndërtimi i këtij termocentrali është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të stabilitetit energjetik dhe uljes së varësisë së vendit nga importet e energjisë elektrike. Sipas njoftimeve, nëse projekti vazhdon pa vonesa, termocentrali duhet të lidhet me rrjetin elektrik brenda një viti. Brenda kuadrit të programit strategjik "Shqipëria 2030", është planifikuar që deri në fund të kësaj dekade, energjia diellore dhe e erës të marrin pjesë me rreth 30% në prodhimin total të energjisë elektrike.

https://www.porta3.mk/vo-albanija-e-pretstaven-proektot-ve-tropoja-so-instalirana-mokjnost-od-600mw/

POTENCIAL I MADH DIELLOR I PASHFRYTËZUAR NE CATITË E BE-SË

Një studim i Komisionit Evropian tregon se panelet diellore në çatitë e BE-së mund të sigurojnë më shumë se gjysmën e energjisë elektrike të nevojshme në pothuajse të gjitha shtetet anëtare. Megjithatë, sistemet diellore aktualisht janë instaluar vetëm në rreth 10% të çative. Studimi, bazuar në një analizë të 271 milionë ndërtesave nëpërmjet imazheve satelitore, vlerëson se rreth 10,000 kilometra katrorë sipërfaqe çatie janë të përshtatshme për energjinë diellore, me një kapacitet potencial prej 2.3 teravatësh dhe një prodhim vjetor prej 2,750 teravatë-orë. Potenciali më i madh është në Francë dhe Gjermani, ku energjia diellore mund të mbulojë deri në 80% të kërkesës aktuale. Kapaciteti total diellor në BE vitin e kaluar ishte 406 gigavat, dhe qëllimi është të arrihet të paktën 700 gigavat deri në vitin 2030. Sipas Eurostat, në qershor 2025, energjia diellore përbënte 22 përqind të prodhimit total të energjisë elektrike në BE.



https://www.euronews.rs/biznis/biznis-vesti/165210/solarni-potencijal-krovova-ogroman-neiskoriscen-izvor/vest

RUAJTJA E ENERGJISË-BAZA E STRATEGJISË BULLGARE ENERGJETIKE

Kompania amerikane ContourGlobal, pranë Stara Zagorës, Bullgari, ka vënë në funksion një sistem të ruajtjes së energjisë në bateri me një kapacitet prej 500 MWh, duke rritur kapacitetin total të ruajtjes në Bullgari me rreth 25%. Sistemi, i cili tashmë po merr pjesë aktive në tregjet e ditës përpara dhe brenda ditës, kontribuon në fleksibilitet dhe stabilitet më të madh të sistemit të energjisë elektrike, veçanërisht në kushtet e rritjes së pjesëmarrjes së burimeve të rinovueshme. Projekti bashkëfinancohet me fondet e BE-së dhe përdor infrastrukturën ekzistuese të rrjetit, e cila lejoi zbatimin rekord. ContourGlobal ka njoftuar gjithashtu ndërtimin e një sistemi të dytë ruajtjeje në të njëjtin vend, i cili pritet ta çojë kapacitetin total të ruajtjes së energjisë në Bullgari në rreth 15,000 MWh, gjë që do të forcojë ndjeshëm sigurinë energjetike të vendit dhe rajonit.



(Skladištenje energije kao oslonac nove energetske strategije Bugarske - Energija Balkana)

CBAM U LANCUA,POR ME RREGULLA TË PAQARTA ZBATIMI

Rregullat e reja të tregtisë së gjelbër të BE-së hynë në fuqi më 1 janar. Mekanizmi i Rregullimit të CO_2, i njohur si CBAM, i detyron kompanitë që shesin mallra me një gjurmë të lartë karboni të provojnë se përputhen me rregullat e emetimeve të ulëta të CO_2 ose përballen me penalitete. Ekspertët paralajmërojnë për pasiguri fillestare në zbatim dhe rritje të mundshme të çmimeve. CBAM fillimisht do të mbulojë energjinë elektrike, hekurin dhe çelikun, aluminin, çimenton, hidrogjenin dhe plehrat, me importet që i nënshtrohen kostove të karbonit të ngjashme me ato që tashmë përballen prodhuesit sipas sistemit të tregtimit të emetimeve të BE-së. Ndërsa industritë e BE-së mbështesin CBAM si një mekanizëm që do të vendosë rregulla të karbonit mbi importet ekuivalente me ato në fuqi brenda Bashkimit Europian, disa kompani paralajmërojnë për kosto të mundshme më të larta pasi lejet e emetimeve falas do të hiqen gradualisht dhe ato do të duhet të blihen në treg. Ndërkohë, Komisioni Evropian ka publikuar vlera standarde për llogaritjen e taksës së karbonit mbi mallrat e importuara, të cilat do të zbatohen kur të dhënat specifike të emetimeve nuk janë të disponueshme, dhe ato bazohen në intensitetin mesatar të emetimeve për të njëjtat produkte të prodhuara në BE.

CBAM počeo da važi uz nejasna pravila primene - Energija Balkana

MEPSO

OPERATOR I SISTEMIT ELEKTROTRANSMETUES
Rr. Maksim Gorki nr. 4, 1000 Shkup

WWW.MEPSO.COM.MK